



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 04.06.2021.

Për: Operatorin “Infosoft Office” sh.p.k. NIPT J62426002Q

Adr: Rruga: “Autostrada Tiranë Durrës, km 8 Kashar, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr. **35, datë 11.12.2020**, me objekt: **“Loti i II-të: “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje)”, Letër A4 Traktor” (3 kopje)** me fond limit 37.080.000 (tridhjetë e shtatë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, me procedure **”Të hapur” me mjete elektronike**, që u zhvillua me datë **18.01.2021, ora 13.00**, [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-82122-12-14-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Loti i II-të: “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje)”, Letër A4 Traktor” (3 kopje)**, me kohëzgjatje kontrate, 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Fondi Limit: 37.080.000 (tridhjetë e shtatë milion e tetëdhjetë mijë) Lekë Pa Tvsh.

Burimi i financimit: Financuar nga te ardhurat e shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **18.01.2021.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Date 21.12.2020 [122]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“Adel Co” Sh.p.k. Nipt L22117021M** me vlerë të ofertës 25.766.000 (njëzetë e pesë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH;

2. Operatori ekonomik “**Infosoft Office.**” Shpk. Nipt J62426002Q me vlerë të ofertës 31,068,000 lekë (Tridhjetë e një milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH;
3. Operatori ekonomik “**Dynamicx Group**” Shpk Nipt L42306022T me vlerë të ofertës 32.600.00 (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH
4. Operatori ekonomik “**Inpress**” Shpk, Nipt L52122014L me vlerë të ofertës 32.700.000 (tridhjetë e dy milion e shtatëqind mijë) lekë; pa TVSH;
5. Operatori ekonomik “**Albdesing**” Shpk, Nipt L51819005Q i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe as dokumentacion;

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**Adel Co**” Sh.p.k. Nipt L22117021M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Oferta ekonomike e paraqitur nga “Adel Co” me vlerë 25.766.000 (njëzetë e pesë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH, rezulton ofertë anomalisht e ulët. Për këtë arsye, në bazë të nenit 56 të ligjit 9643 Për Prokurimet Publike (me ndryshimet), si dhe nenit 66 pika 5, të VKM-së Nr.914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ne datën 12.02.2021 i ka dërguar mesazh elektronik në sistem operatorit dhe i ka kërkuar, argumentim me shkrim për elemente të veçantë të ofertës: anën ekonomike, cilësinë e produkteve, reference doganore për artikuj objekt prokurimi të pasqyruar dhe në bilancin e Shoqërisë. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të jetë jo në formë deklarative, por të jetë dokumentacion që të vërtetojë kryerjen e transaksioneve dhe të jetë i gjurmueshëm në sistemin tatimor ose doganor, apo ndonjë kusht tjetër favorizues të kësaj oferte, zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me kushtet e punës. Argumentimi me shkrim duhet të dërgohet në formë elektronike dhe zyrtare, jo më vonë se data 15.02.2021 ora 14.00.

Në datën e përcaktuar nga Kvo operatori ekonomik nuk ka dhenë sqarime mbi ofertën anomalisht të ulët sikurse citohet në nenin 66 pika 5, të VKM-së Nr.914, datë 29.12.2014 “Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LP”.

2. “**Albdesing**” Shpk, Nipt L51819005Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe as dokumentacion

3. “**Dynamicx Group**” Shpk Nipt L42306022T

- Nuk plotësohet pika 2.3.12 në kriteret e vecanta pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur dorazi moster per zerin ”Letër A5 ”Traktor” (3 kopje) ne datën dhe orën e hapjes së Tenderit. Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim"

- **Nuk plotësohet pika 2.3.8** në kriteret e vecanta pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për makineri për mbledhjen e letrës së vazhduar të birosur dhe makineri për biosjen e letrës (ose ekuivalente). Fatura tatimore me date 05.01.2021 nr 2, e paraqitur për përmbushjen e kësaj pike nuk është e nënshkruar nga blerësi dhe si rrjedhojë nuk vërtetohet që operatori ekonomik i disponon këto makineri.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin “**Infosoft Office**” sh.p.k. NIPT J62426002Q, **Adresë:** Rruga “Autostrada Tiranë Durrës, km 8 Kashar, Tiranë, [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me vlerë 31,068,000 (Tridhjetë e një milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) **Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Posta Shqiptare Sh.a. Rr.“Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, Sektori i Prokurimeve, kati IV [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 32.700.000 (tridhjetë e dy milion e shtatëqind mijë) *lekë pa TVSH*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa: ka ose jo: Lidhur me DST-në, me datë 21.12.2020 kemi patur ankesë nga operatori ekonomik “Infosof Office” sh.p.k.,

Brenda afateve ligjore, autoriteti kontraktor ka shqyrtuar ankesën duke i kthyer përgjigje operatorit ankimues me shkresën nr. 2575/6 prot. Datë 24.12.2020.

Brenda afateve ligjore operatori ekonomik nuk ka ankimuar procesin në KPP.

Me datë **18/01/2021, ora 13.00** është bërë mbyllja e dorëzimit të ofertave në SPE.

Njoftimi i klasifikimit është bërë me datë **19.02.2021**.

Ankesa: ka ose jo:

Lidhur me vlerësimi e ofertave, më datë **22.02.2021** ka paraqitur ankesë operatori ekonomik “**Inpress**” sh.p.k. NIPT **L52122014L**.

Më datë 24.02.2021, ka paraqitur ankesë operatori ekonomik “Dynamicx Group” Shpk, duke pretenduar që është skualifikuar padrejtësisht

Brenda afateve ligjore janë trajtuar ankesat dhe më datë **02.03.2021** u është kthyer përgjigje operatorië ankimues.

Më datë 12.03.2021 pranë Autoritetit tonë Kontraktor, vjen nga KPP-ja vendimi Nr. 394/1 prot. Datë 10.03.2021, më objekt: “Urdhër për pezullim procedure prokurimi, shqyrtim në themel”, lidhur me këtë procedurë prokurimi.

Në zbatim të këtij vendimi është dërguar pranë KPP_së i gjithë informacioni i kërkuar lidhur me procedurën.

Në përfundim të hetimit administrativ, KPP-ja me Vendimin **Nr. 246/2021 prot., Datë 28.05.2021**, ardhur në “Posta Shqiptare” sh.a. me **Nr. 2575/33 prot. datë 03.06.2021**, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ankimues “**Inpress**” sh.p.k. **L52122014L**.

Në zbatim të pikës 2, të Vendimit **Nr. 246/2021 prot., Datë 28.05.2021** të Komisionit të Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Laert Duraj

**ME AUTORIZIM
DREJTOR I DREJTORISË JURIDIKE
Hipokrat Biba**